



*Dr. Ilir Muharremi*

### *Imazhet e regjimit Stalinian në artin e Kseniya Simonova<sup>1</sup>*

Vajzë e talentuar, sharmante, tërheqëse, me një fizionomi të kompletuar, e stërmbushur me art, vullkan formash ngjarjesh e përplasur me të kaluarën e dhimbshme të popullit të Ukrainës, artistja Kseniya Simonova krijon imazhe në rërë. Pikturat e saja në rërë tregojnë një ngjarje, një tregim që rrjedhin njëra pas tjetrës. Arti i saj nuk është aspak i ngarkuar me absurditetet dhe as marrëzira, është e simpatizuar dhe e simpatizojnë gjithnjë njerëzit, madje edhe ata që ju ka munguar kultura artistike. Depërton idealisht, praktikisht dhe estetikisht në çdo kokë, krijon histori të dhimbshme ilustron forma nga asgjëja, nën shoqërinë e muzikës, përformon bindshëm, dhe zgjon nostalgji të pasionuar të kulturës Ukrainase apo shtypjes vulgare të këtij populli nga diktatori Stalin.

Dashuria, misteri, apo tentimi për ta pushkatuar arsyen, prekin thellësinë e artistes, dhe e detyrojnë në formë absolute, tendencioze, të protestojë për një të kaluar e cila ende jeton, ngase shenjat e saja janë ngulitur thellë tek ky popull. Kjo artiste është tejet përparimtare, paraqet trupin si objekt tokësor, material i njeriut, nxjerr në pah bukurinë përmes shkëlqimit të dilërsisë shpirtërore, duke e bërë artin mjet qëllimi për lartësimin moral të njeriut. Harmoninë e trupi, shpirtin e shndërron me dilërsinë artistike dhe aty fiton arti me vlera të mirëfillta etike dhe estetike. Dora e krijueses shpreh qetësinë, paqen, lirinë dhe shmangie e konfliktit

<sup>1</sup> Kseniya Simonova....Info: <http://simonova.tv/en/>

abuziv politik. Në një video të njohur, tashmë të shfaqur edhe në youtube, nën shoqërinë e muzikës, ajo përformon duke krijuar forma reale me proporcione të sakta trupore, dhe kompozicion profesional që gërsheton perspektivën hamëndëse. Çifti i ulur në ulëse shndërrohet në fytyrë femre. Vetmitari i cili bredh rrugëve, në zjarr. Vejusha shndërrohet në monument, ushtari e vështron përtej dritares, cili përfaqëson panjohuri për vejushën e mjerë. Dukuritë nuk janë dekadente, kanë ekuilibër, harmoni, mesazh moral, zbulim fisnikërues të mirëfilltë estetik, dhe tek njeriu zgjon, valëvitë thellësinë si një flamur dorëzues pranë një skene rrëqethëse. Arti i saj është kryengritje ndaj padrejtësive që janë bërë dhe që vazhdojnë të bëhen. Ajo nuk kundërshton moralizimin, por hipokrizinë dhe është përfaqësuese e artit për art. Bukuria e artit të saj, nëpërmjet imazheve filmike tregon përsosmërinë e kulluar të estetikës morale dhe amorale. Arti ka një thelb të kulluar dhe që pak e hiç nuk kuptohet me ndonjë formë ideore, por me vulgaritet, ekstazë, edhe me vuajtën e gjatë. Publiku në momentin e përformimit të artistes së re, përjetojnë një rrëqethje të brendshme instiktive amorale, por njëkohësisht luftë me moralin. Krejt kjo na vije nën shoqërinë e muzikës, e cila ndërron skenën, kuadrot, dhe krijon lojën e përjetësisë.

Një artiste e madhe, e cila arrin ta tronditë botën, dhe të brohorit pa mëshirshëm me artin, duke kujtuar dhe paralajmëruar Evropianët dhe kontinentet tjera, se regjimi Stalinian, ishte një hipokrizi. Derisa dhimbja rrëshqet si një formë natyraliste ose kriter objektiv me pikëpamje morale, e vërteta zgjohet nga pluhuri i kohës konservatore dhe bëhet një reaksion që qel një rrugë të drejtë përparimtare. Format që i krijon në rërë, nuk përplasen stoikisht, dhe nuk qëndrojnë në heshtje ose në qetësi, por historikisht shndërrohen nga njëra formë në tjetrën, duke shprehur karakterin historik amoral ndaj drejtësive të çoroditura. Teknika me rërë nuk është diçka tejet e re për artin botëror, por zgjimi i abuzimit, trajtimi artistik ku zhvillohet loja në mes dhimbjes dhe durimit, paqes dhe luftës, të bukurës dhe të shëmtuarës, arrin majën dhe spektatorit i jep botën shpirtërore ngase përziën ndjenjën me mendimin.

Kështu ndodh edhe në jetën e zakonshme. Prandaj, vërtetësia jetësore është kusht themelor që idetë bëhen estetike. Përfytyrimet e saja, mbresat plot jetë, i jep imagjinata e pasionuar, ngase kjo është forca dhe shtytja me triumfale e artistes. Në mes tragjikes dhe dramës krijon arsyttime filozofike domethënëse të jetës dhe

luftës për të fituar e drejta. Koha, mënyra e të jetuarit, harmonia, dashuria, zhurmojnë nëpërmjet rërës, e cila krijon përjetim emocional dhe të gjithëve na bënë poet që na zhyt pas vargjeve të vazhduara. Imazhet janë formalizim figurativ të mbingarkuara figurativisht, drejt një mbivlerësimi të realizmit, kurse nënvlerësim i aktit kohor me përmbajtje hipokrizie. Dhe, për fund, modeli i botës shpirtërore të artistes reflekton unitetin e anës emocionale dhe intelektuale të pa mësuar nga dikush, por të interpretuara thellësisht vetëm për shpirtin, ose siç kishte me thënë Tarkovski : ” Arti nuk mësohet, se në art nuk ka mësues.”

PR

DIOGEN pro kultura

<http://www.diogenpro.com>

NE KOPIRATI